



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 233, Datë 19.07.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, si dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 57/9 prot., datë 14.07.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1757 prot., datë 07.06.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 19.06.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.06.2023 dhe 21.06.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1757/4 prot., datë 23.06.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e plotësuar pjesërisht të këtij aplikimi.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1757/6 prot, datë 04.07.2023 dhe nr. 1757/8 prot., datë 13.07.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s, pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pika 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Për sa bërë me dije nga vetë shoqëria se sistemi IT do të bëhet funksional duke filluar nga data 01.04.2024, vlerësohet t’i lihet kusht që para fillimit të operimit, të njoftojë ERE-n për bërjen funksional të këtij sistemi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Para fillimit të operimit, shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen funksional të sistemit IT.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI